

Brevis®

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Lenda vepruese: 150 gr/kg Metamitron+Diformat calcium.
Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë (WG).
Nr dhe data e regjistrimit: 761, datë 28.04.2021



RREGULLATOR RRITJE PËR BIMËT QË PËRDORET PËR RRALLIMIN E KOKRAVE NË MOLLË DARDHË DHE RRUSH TAVOLINE.

MASAT PARAMBROJTËSE: • P102: Mabajeni në vende të sigurta dhe të pa arritshme nga fëmijët; • Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë; • P270: Mos hani, mos pini lëngje dhe duhan gjatë përdorimit të këtij produkti; • P280: Gjatë punës përdor pajisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze; • P305 + P351 + P338 - në rast kontakti me sytë: lajini me kujdes për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit nëse janë të pranishme dhe të lehta për tu bërë. Vazhdoni shpërlarjen; • P310: Në rast helmimi lajmëroni qendrën shëndetësore më të afërt dhe i tregoni mjekut etiketën; • P501: Asgjësoni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret kombëtare në fuqi. • H302 - I dëmshëm nëse gëlltitet • H318 - Shkakton dëmtim serioz të syeve;

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN. • Në rast të thithjes së avujve, nxirëni të dëmtuarin në ajër të pastër. Kur frymëmarrja nuk është e regullt ose ndalon, administroni frymëmarrjen artificiale. Telefononi mjekun dhe i tregoni etiketën e produktit. • Në rast kontakti me lëkurën: hiqni rrobat e ndotura, lani menjëherë pjesët e kontaminuara me ujë të bollshëm dhe sapun. Në rast kontakti me sytë: shplajni me ujë të bollshëm, pas heqjes së lenteve vazhdoni shpërlarjen për të paktën 15 minuta. • Në rast se produkti është gëlltitur, mos shkaktoni të vjella. Shpëlani menjëherë gojën dhe pini sa më shumë ujë. • Nuk ka antidot specifik dhe terapia është simptomatike.

Përdorimi: BREVIS® shkakton disbalancim energjetik duke penguar fotosintezën përmes frenimit të transportit fotosintetik të elektroneve në fotosistemin II. BREVIS® vepron në fotosintezën e bimës, duke nxitur bimët të hedhin frutat dhe duke ndihmuar në rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit. Në mollë: Përdorni BREVIS® në një dozë 1.1 kg/ha, kur madhësia mesatare e frutave qëndrore (diametri) është 8-10 mm për kultivatet që kimsisht rrallohen lehtë dhe 1.65 kg/ha kur diametri i kokres është 10-12 mm. Per kultivatet që kimsisht rrallohen në veshitësi përdoret doza 1.65 kg/ha kur diametri i kokres është 8-12 mm. Mos kryeni më shumë se dy trajtime në një sezon për një total maksimal të dozës deri 4.4 kg/ha. Trajtimi i dytë mund të bëhet jo më herët se 5-10 ditë pas aplikimit të parë me kusht që madhësia e frutave të jetë 12-14 mm por jo me shumë se 16 mm. Bimët me një grup të madh frutash dhe kultivatet që kanë veshitësi në rralim mund të kenë nevojë për një trajtim të dytë. Në dardhë: përdorni BREVIS® në një dozë prej 1.1-1.65 kg/ha (doza e rekomanduar 1.1 kg/ha) kur madhësia mesatare e frutit qëndror është midis 8 - 12 mm. Mos bëni një aplikim të dytë. **Rrushi i tavolinës:** Përdorni BREVIS® në një dozë prej 2.8-3.5 kg/ha midis fazës së caktuar të frutave (BBCH 71), kur shumica e kokrave janë zhvilluar dhe ndodh rënia e plotë e mbetjeve të luleve, dhe faza në të cilën kokrat kanë arritur madhësinë e kokrës së piperit të zi (BBCH73). Mos bëni një aplikim të dytë. Përdorni vëllime uji që nuk i kalojnë 1000 l/ha.

Vërejtje për përdorimin: Bimët në kushte stresuese janë më të ndjeshme ndaj efektit të produktit. Për të shmangur çdo efekt të pafavorshëm në bimë të tjera, është e nevojshme të shmanget trajtimi edhe në kushte të lehta të erës. Lani me kujdes pajisjet në fund të aplikimit. Efekti i BREVIS® kur bimët janë në një situatë stresuese (dëmtime të mëdha të shkaktuara nga era, breshëri, thatësira ose faktorë të tjerë të ndryshëm) mund të jetë më i madh. Përdorimi i rjetave anti-breshër mund të rrisë efektivitetin e BREVIS® për shkak të zvogëlimit të pjeshëm të rrezatimit diellor në dispozicion të bimëve. Në fakt, për shkak të mënyrës së tij të veprimit sinjël frenues i fotosintezës, aktiviteti i BREVIS® ndryshon në përputhje me kushtet e ndryshme atmosferike (në veçanti nivelet e rrezatimit diellor) para, gjatë dhe pas aplikimit dhe nga fuqia e impiantit. Moti me re dhe temperaturat e larta të natës (>10°C) gjatë javës para dhe pas aplikimit mund të rrisin efektin e trajtimit. Në këto kushte, doza e aplikimit duhet të përshtatet dhe çdo aplikim i dytë të vlerësohet me kujdes. Kontrolloni kushtet ditore të motit në qendren më të afërt meteorologjike një javë para datës së planifikuar për aplikimin e parë; vlerësoni motin në 2 javët e ardhshme për të vendosur momentin e aplikimit të dytë duke respektuar indikacionet agronomike të paragrafit të dedikuar. BREVIS® duhet të aplikohet në temperatura të ditës mbi 10 °C dhe asnjëherë në temperatura mbi 25°C. Mos e aplikoni BREVIS® brenda 5 ditëve para ose pas një acari të mundshëm. BREVIS® nuk duhet të aplikohet në gjethë të lagura, jo shumë herët në mëngjes ose menjëherë pas shirave. Shiu që ndodh 2 orë pas trajtimit nuk rrezikon efektivitetin e produktit. Në pëmishtet e karakterizuara nga një rritje e fuqishme, me një numër të lartë lastarësh, veprimi i BREVIS® mund të jetë më i madh për shkak të një konkurrence më të lartë për fotosintezë midis bimësisë dhe frutave. Prandaj, doza duhet të zvogëlohet. Rekomandohet të mos përdorni BREVIS® në pëmishtet e mollëve më pak se 4 vjeç dhe në bimët e dardhës më pak se 7 vjeç. Formulimet vajore dhe disa aditivë për të përmirësuar thithjen nuk duhet të përdoren kurrë në kombinim me BREVIS®.

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik kur përdoret në dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi në mjedis: Pak helmues për bletën. EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorimin. H411 - Toksik për jetën ujore në efekte afatgjata. Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos pastroni pajisjet e punës në afërsi të ujërave sipërfaqësore. Shmangni kontaminimin përmes sistemeve të kullimit të ujit nga fermat dhe rrugët. Për të mbrojtur organizmat ujorë afër parcesës që do të trajtohet respektoni një brez sigurie të pa trajtuar me gjerësi prej 5 metrash nga ujrart sipërfaqësore.

Karenca: Trajtimet ndërpriten 60 dite para vjeljes së mollëve, dardhëve dhe rrushiit të tavolinës.

Ruajtja dhe magazinimi: Ruhet në vende të thata, të ajrosura, larg rrezeve direkte të diellit, në temperaturë deri 35°C.



"I rrezikshëm"

MELDI Sh.p.k

Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tirane - Shqipëri



Prodhesi: ADAMA Agan Ltd. P.O.B 262,
Ashdod, Izrael;
Aplikanti: ADAMA Agriculture B.V.,
Arnhemseweg 87, 3832 GK
Leusden, Holandë.

Dt. Prodhimit: stampuar ne ambalazh
Periudha e ruajtjes: 3 vjet

6 x 0.5kg = 3kg